

Projekti është i financuar nga “Fondacioni Shoqëri e hapur – Maqedoni”

Observatori për reforma mediatike

Raporti përfundimtar nga vëzhgimi i përbushjes së reformave prioritare nga fusha e mediave

Periudha e raportimit: 1.7.2017 – 30.9.2018

Ky raport është rezultat i procesit të vëzhgimit të realizimit të reformave prioritare (RUP) nga fusha e mediave në kuadër të projektit “Observatori për reforma mediatike”, të cilin e realizojnë Fondacioni “Metamorfozis”, “Agora” dhe PINA. Projekti është i mbështetur nga “Fondacioni Shoqëri e hapur në Maqedoni (FSHHM).

Të gjitha materialet që janë produkt i këtij projekti dhe i vëzhgimit të realizuar gjenden në ueb-faqen e veçantë të dizajnuar për nevojat e projektit. Ueb-faqja është: mediaobservatorium.mk

tetor 2018

Informatat dhe qëndrimet e publikuara nuk i paraqesin qëndrimet zyrtare të Fondacionit Shoqëri e hapur - Maqedoni.

Projektin “Observatori për reforma mediatike”, e realizon Fondacioni për internet dhe shoqëri “Metamorfozis”, në partneritet me SHQ “Agora” – Qendra për promovimin e vlerave qytetare dhe PINA – Platforma për gazetari hulumtuese dhe analiza.

Përmbajtja

Përmbledhje e shkurtër	3
Hyrje.....	5
Qëllimet dhe metodologjia e vëzhgimit.....	8
Qëllimi dhe metodat e raportit.....	8
Hulumtimi	9
Raportet e Grupit të ekspertëve të pavarur me përvojë, të udhëhequr nga R. Pribe.....	10
Konstatimet kyçe nga vëzhgimi	11
1. Transmetuesi publik i radiodifuzionit	11
2. Reklamimi qeveritar	14
3. Qasja te informatat	16
4. Shpifja	19
Literatura e shfrytëzuar	20

Shkurtesat

RM – Republika e Maqedonisë;

BE – Bashkimi Evropian;

KE – Komisioni Evropian;

RUP – Reformat urgjente prioritare; reformat prioritare;

ASHAAM – Agjencia për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike;

GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

SHGM – Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë

Fjalët kyçe

Media-vëzhguese, media-vëzhgim, reformat prioritare (urgjente), Pribe, mediat, transmetuesi publik i radiodifuzionit, reklamimi qeveritar, qasja te informatat, shpifja.

Vërejtje





Teksti është përgatitur në kuadër të projektit “Observatori për reforma mediatike”, të cilin e realizojnë Fondacioni për internet dhe shoqëri “Metamorfozis”, “Agora” – Qendra për promovimin e vlerave qytetare dhe Platforma për gazetari hulumtuese dhe analiza (PINA), me mbështetje financiare të “Fondacionit Shoqëri e hapur – Maqedoni”.

Përmbajtja e tekstit është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e “Fondacionit Shoqëri e hapur – Maqedoni”.

Përmbledhje e shkurtër

Ky raport përfundimtar i prezanton rezultatet e përgjithshme nga vëzhgimi i përbushjes së Reformave urgjente prioritare (RUP) që kanë të bëjnë me lirinë e të shprehurit, në periudhën prej 1 korrikut deri më 30 shtator të vitit 2018, në kuadër të projektit “Observatori për reforma mediatike”, të cilin e realizojnë Fondacioni për internet dhe shoqëri “Metamorfozis”, “Agora” – Qendra për promovimin e vlerave qytetare dhe Platforma për gazetari hulumtuese dhe analiza (PINA), me mbështetje financiare të Fondacionit Shoqëri e hapur – Maqedoni.

Si rezultat i vëzhgimit të katër shtyllave të RUP, u përcaktuan këto konstatime kyçe:

- **Transmetuesi publik i radiodifuzionit** – financimi i ri buxhetor i RTM-së tregoi se është në nivel më të ulët se sa më parë dhe se nuk do t’i plotësojë nevojat për funksionim normal të transmetuesit publik. Prandaj, në korrik të vitit 2018 me rebalancin e buxhetit, Kuvendi 3 milionë euro të tjera për këtë vit për transmetuesin publik. Ndryshimet e filluara në legjislacionin e mediave nuk mundën të përfundojnë në Kuvend. Ndryshimet e nevojshme të ligjit përkatës ende nuk janë miratuar në Kuvend. Këshilli Programor i RTM-s, në përbërjen e të cilit ka anëtarë që kanë bartës të mëparshëm të funksioneve publike, e rizgjodhi drejtorin aktual të RTM-së. Shërbimet programore të televizionit janë në formatin e njëjtë edhe përkundër obligimit ligjor për hapjen e kanalit të katërt televiziv. Nuk është regjistruar asnjë hap reformues për ta përmirësuar punën dhe cilësinë e përmbajtjes së programit/ofertës në transmetuesin publik. 
- **Reklamimi qeveritar** – Edhe pse janë hequr reklamat qeveritare në mediat e vendit, qeveria nuk ofroi sqarime të detajuara për një sërë aspektesh të veçanta për të siguruar transparencë të plotë dhe llogaridhënie, duke publikuar rregullore, procedura apo protokolle. Përveç kësaj, në nenin 102 të Propozim-ligjit për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike është lënë mundësia për reklamim të qeverisë, institucioneve qeveritare dhe ndërmarrjeve të tjera publike. 
- **Qasja në informata** – Përveç masave të ndërmarra nga ana e qeverisë për hapjen e bazave publike për gazetarët, disa ministri kanë hapur qasje onlajn për publikun e gjerë në të dhënat për shpenzimet, kontratat e tenderëve dhe furnizimet. Mbetet e pandryshuar situata në lidhje me ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për qasje në informatat me karakter publik. Pas thirrjes deri te publiku i gjerë dhe ekspertët për të dhënë sugjerime për ndryshime, nuk janë formuar grupe pune në kuadër të Ministrisë për Drejtësi, e as që ka filluar ndonjë aktivitet në këtë drejtim. Rrethanë plotësuese rënduese është edhe jofunksionaliteti i Komisionit. Ai funksionon pa kryetar dhe pa dy anëtarë, që do të thotë se nuk ka mandat të sjellë vendime në lidhje me ankesat për qasjen në informatat me karakter publik. Ekipimi kadrovik i Komisionit pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2018. 
- **Shpifja dhe ofendimi** – Në këtë fushë nuk ka asnjë ndryshim dhe zhvillim në periudhën e ndjekjes dhe të raportimit. Edhe përkundër faktit se është evidentuar rënie në numrin e padive dhe të kontesteve kundër gazetarëve 

për shpifje dhe ofendim, ende ekziston dilema te gjykatat se a duhet të trajtohen mediat onlajn dhe të punësuarit e tyre si media/gazetarë apo jo. Praktika gjyqësore tregon se ka interpretim arbitrar për këto subjekte dhe për gazetarët që punojnë në këtë lloj të mediave, për të cilën gjë komuniteti profesional i OJQ-ve reagon vazhdimisht. Ndaj reagimeve formale administrative-juridike akoma nuk ka vendim nga instancat më të larta gjyqësore. Nuk është ndërmarrë iniciativë për ndryshimin e Ligjit për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe ofendim dhe të rregullave procedurale me qëllim që të harmonizohen me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Qeveria nuk ka filluar koordinim me ekspertët në këtë drejtim.

Observatori për reforma mediatike do të vazhdojë me ndjekjen e realizimit të Reformave urgjente prioritare edhe në periudhën e ardhshme, duke i prezantuar rezultatet në formë të raporteve periodike, lajmeve dhe storjeve hulumtuese, me qëllim të përfshirjes sa më të madhe të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në proceset demokratike. Të gjitha rezultatet nga ndjekja e realizimit të reformave gjenden në ueb-faqen MediaObservatorium.mk në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.

Hyrje

Kriza politike në Republikën e Maqedonisë e arriti kulmin gjatë vitit 2015, kur u shoqërua me: publikimin e bisedave të përgjuara të funksionarëve të lartë të qeverisë dhe të liderëve të partive politike, ngritjen e padive penale për publikimin e paligjshëm të këtyre materialeve, si dhe me një numër të madh protestash në një shenjë të revoltës për shkak të incizimeve të publikuara dhe përmbajtjeve të tyre. Për shkak të shkallës së krizës dhe natyrës së saj, u përfshi edhe faktori ndërkombëtar, nën udhëheqjen e të cilit u zhvilluan negociatat për pajtim dhe zgjidhje të krizës. Partitë politike me ndërmjetësimin e bashkësisë ndërkombëtare, të udhëhequr nga BE-ja dhe SHBA-të, arritën një marrëveshje kompromisi në qershor 2015 – Marrëveshjen e Përzhinës¹, me të cilën partitë politike nënshkruese ranë dakord për një zgjidhje përfundimtare të krizës, si dhe për të ndërmarrë zgjidhje sistematike dhe reforma për t'i përmbushur rekomandimet e dhëna nga Komisioni Evropian, në kuadër të kësaj marrëveshjeje, mirëpo dhe me proceset e mëparshme për t'i përmbushur kërkesat e vendit për hapjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

Menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Përzhinës, Komisioni Evropian për Maqedoninë përgatiti një dokument të posaçëm me reforma prioritare (Urgent Reform Priorities – Reforma urgjente prioritare; RUP) për Maqedoninë², të cilat vendi duhet t'i përmbushë në fushën e sundimit të ligjit, depolitizimit të administratës publike, lirisë së shprehjes dhe reformave zgjedhore.

Reformat urgjente prioritare (RUP) janë një dokument që ndërlidhet me Raportin e ekipit të ekspertëve të udhëhequr nga Reinhard Priebe³. Ai ndahet në pesë kapituj: Sundimi i ligjit dhe gjyqësia; Depolitizimi i administratës publike; Reformat zgjedhore; Implementimi i rekomandimeve të Komitetit anketues për ngjarjet e 24 dhjetorit; Mediat: liria e shprehjes.

Në përputhje me negociatat për arritjen e Marrëveshjes së Përzhinës, por në mënyrë eksplicite edhe me reformat prioritare, reformat në fushën e mediave dhe lirinë e shprehjes janë thelbësore për zhvillimin e një pushteti transparent, demokratik dhe të lirë në vend. Konkretisht, reformat në fushën "Mediat: Liria e shprehjes" synojnë të arrihet përparim dhe të zgjidhen problemet në katër fusha: transmetuesi publik, reklamimi qeveritar, qasja në informata dhe shpifja.

Rëndësinë e reformave në media dhe lirinë e shprehjes e njohu edhe qeveria aktuale, e cila parashikoi masa dhe aktivitete në këtë fushë në programin e saj për punë të Qeverisë 2017-2020⁴, si dhe në kuadër të planit "3-6-9"⁵. Në përputhje me këto dokumente, Qeveria u përkushtua që në pjesën e mediave të ndërtojë partneritet me shoqatat dhe me sektorin civil që ta lirojë hapësirën mediatike nga çdo ndikim institucional ose personal, duke përfshirë edhe varësinë financiare.

Projekti "**Observatori për reforma mediatike**" i ka ndjekur proceset dhe përmbushjen e **RUP** në pjesën për mediat dhe lirinë e shprehjes në periudhën midis 01.07.2017 dhe 30.06.2018, duke

¹ Przino Agreement – Agreement in Skopje to overcome political crisis, 2 June 2015, Skopje https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_agreement.pdf

² Reformat urgjente prioritare – përkthim në gjuhën maqedonase: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_mk.pdf. Në origjinal në gjuhën angleze: Urgent Reform Priorities for Macedonia, Komisioni Evropian, DGJ Politika evropiane për fqinjësi dhe negociatat për zgjerim, qershor 2015 https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_en.pdf

³ Recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues relating to the communications interception revealed in Spring 2015, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf

⁴ Programi për punë i Qeverisë së RM-së, http://vlada.mk/sites/default/files/programa/2017-2020/Programa_Vlada_RM_Juni_Dekemvri_2017.pdf

⁵ Qeveria e RM-së, plani "3-6-9", <http://vlada.mk/plan-3-6-9>

publikuar raporte periodike dhe storje gazetareske në lidhje me katër fushat në sferën mediatike, për të cilat ishte potencuar nevoja për reforma, me çka publikut iu mundësua qasje në përbushjen e procesit të reformave në këto fusha që dalin nga dokumentet e sjella nga aktorët politikë të vendit dhe bashkësia ndërkombëtare me qëllim të zgjidhjes së krizës disavjeçare në Republikën e Maqedonisë.

Sipas [Raportit të parë periodik të projektit](#)⁶, reformat bazohen në raportin e [parë](#)⁷ dhe të [dytë](#)⁸ të ekipit të ekspertëve, të udhëhequr nga ish-komisari i BE-së, Rajnhard Pribe, të qershorit të vitit 2015 dhe të shtatorit të vitit 2017, [Reformat urgjente prioritare të BE-së për Maqedoninë – RUP për Maqedoninë](#)⁹ dhe në Marrëveshjen e Përzhinës¹⁰ të arritur në korrik të vitit 2015.

Edhe përkundër angazhimit të Qeverisë për të ndërtuar partneritetet me shoqatat dhe sektorin civil në sferën e mediave, kjo sferë ende nuk është çliruar nga ndikimet institucionale ose personale për shkak të ngadalësisë me të cilën Kuvendi i miraton ndryshimet e nevojshme ligjore.

Në periudhën e ndjekjes së proceseve nuk ka asnjë lëvizje në pjesën e ndryshimeve konkrete të rregullativës ligjore me të cilën do të përshpejtoheshin proceset dhe e cila do të shërbente si bazë për pavarësi, depolitizim dhe departizim të institucioneve publike. Koalicioni qeverisës nëpërmjet përfaqësuesve të tij në Kuvendin e RM-së nuk i solli dhe nuk i miratoi ndryshimet e nevojshme të Ligjeve¹¹ nga prioritetet sipas Pribe, që kanë të bëjnë me sferën e mediave: lirinë e shprehjes. Edhe pse në disa prej katër shtyllave¹² me të cilat vlerësohet liria e shprehjes ka përparim të konsiderueshëm, mirëpo mosmiratimi i ndryshimeve kryesore ligjore e pengon procesin e reformave.

Atmosferën e tillë të paqartë dhe të pandryshuar mediatike e tregon edhe [raporti i Unionit evropian të radiodifuzionit \(EBU\)](#)¹³ sipas të cilit besimi i qytetarëve të Maqedonisë në mediat e vendit është ndër më të ulëtët në Evropë. Ky opinion i qytetarëve për mediat është theksuar edhe në [raportin e Departamentit të Shtetit të SHBA-ve](#), i cili i referohet situatës me mediat gjatë vitit 2017, dhe i cili u publikua në prill të këtij viti¹⁴. Nga ana tjetër, në [Raportin e KE-së](#) për përparimin e Maqedonisë, të publikua më 17.4.2018¹⁵, në pjesën që ka të bëjë me mediat, thuhet se ka përparim në lirinë e shprehjes në krahasim me periudhën e mëparshme. Përveç kësaj, në të theksohet se ka rënie të presionit ndaj gazetarëve. Përparim në sferën e mediave në Maqedoni, kanë regjistruar edhe

⁶ Observatori për reforma mediatike, Raporti i parë periodik nga vëzhgimi i përbushjes së reformave prioritare nga fusha e mediave <http://mediaobservatorium.mk/wp-content/uploads/2017/11/Raporti ORM 1.pdf>

⁷ Recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues relating to the communications interception revealed in Spring 2015, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf

⁸ The former Yugoslav Republic of Macedonia: Assessment and recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues 2017, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf

⁹ Reformat urgjente prioritare – përkthim në gjuhën maqedonase:

https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_mk.pdf. Në origjinal në gjuhën angleze: Urgent Reform Priorities for Macedonia, Komisioni Evropian, DGJ Politika evropiane për fqinjësi dhe negociatat për zgjerim, qershor 2015 https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_en.pdf

¹⁰ Przino Agreement – Agreement in Skopje to overcome political crisis, 2 June 2015, Skopje https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_agreement.pdf

¹¹ Ligji për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike; Ligji për qasje të lirë në informatat me karakter publik; Ligji për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe ofendim.

¹² **Transmetuesi publik i radiodifuzionit, reklamimi qeveritar, qasja në informata dhe shpifja.**

¹³ <http://mediaobservatorium.mk/sq/besimi-ne-mediat-ne-maqedoni-nder-me-te-ulet-it-ne-evrope/>

¹⁴ <http://mediaobservatorium.mk/stejt-departmentot-vide-potchineti-mediumi-napadi-vrz-novinari-i-nedoverba-na-javnosta/>

¹⁵ <http://mediaobservatorium.mk/ek-ima-napredok-vo-slobodata-na-izrazuvane-namalen-e-priteisokot-vrz-novinarite/>

[“Raportuesit pa kufij”, të cilat në raportin e tyre](#)¹⁶ e kanë përmirësuar pozitën e vendit nga vendi i 111-të në vendin e 109-të sipas Indeksit të lirisë së mediave në botë.

Nga ana tjetër, komuniteti i gazetarëve të Maqedonisë ende ankohet se edhe pas ndryshimit të pushtetit, [gazetarët përballen me presione](#)¹⁷. Praktikën me të cilën vazhdon mosndëshkimi i dhunuesve të gazetarëve e përmend edhe Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) në [Buletinin](#)¹⁸ e saj (prill, maj dhe qershor 2018). Nga 50 rastet në të cilat janë sulmuar gazetarët gjatë kryerjes së detyrave të tyre profesionale, këtë vit vetëm një ka përfunduar me aktgjykim për sulmuesin.

¹⁶ <http://mediaobservatorium.mk/reporteri-bez-granitsi-omrazata-kon-novinarstvoto-e-zakana-za-demokratijata/>

¹⁷ <http://mediaobservatorium.mk/novinarite-se-soochuvaat-so-pritisotsi-i-po-promenata-na-vlasta-2/>

¹⁸ <http://znm.org.mk/wp-content/uploads/2018/07/Билтен-на-Здружението-на-новинарите-на-PM-април-мај-јуни-2018.pdf>

Qëllimet dhe metodologjia e vëzhgimit

Qëllimi dhe metodat e raportit

Ky raport është dedikuar, para së gjithash, për informimin e publikut të gjerë ose qytetarëve për procesin e realizimit të RUP në fushën e mediave, në mënyrë të kuptueshme, të përshtatshme për opinionin e gjerë dhe publikun joekspert. Poashtu, raporti do t'i informojë edhe palët e tjera të interesuara, siç janë mediat, institucionet dhe sektori qytetar.

Raporti ka për qëllim të sigurojë informata adekuate për përparimin e realizimit të reformave të parapara në fushën e mediave.

Ky raport është përgatitur në përputhje me metodologjinë e përgatitur ekskas për vëzhgim, që përfshin një sërë aktivitete dhe masash për mbledhjen e të dhënave dhe për ndjekjen e proceseve të reformave. Metodologjia bazohet në zbatimin e një sërë aktivitete hulumtuese, duke filluar nga analiza e kornizës aktuale juridike dhe analiza e gjendjeve në media dhe me lirinë e të shprehurit, pastaj zbatimin e vëzhgimit ditor dhe periodik, si dhe analizat hulumtuese, organizimin e grupeve të fokusit me persona që kanë informata kyçe etj.

Hulumtimi në zyrë është i fokusuar në mbledhjen e të dhënave dhe në analizën e të gjitha dokumenteve relevante që kanë të bëjnë me realizimin e RUP në fushën e mediave, siç janë raportet vjetore të BE-së për Maqedoninë, raportet e Pribes, si dhe dokumentet dhe raportet e institucioneve nacionale ose organizatave që kanë të bëjnë me reformat prioritare të mediave. Këto të dhëna sigurohen nëpërmjet kanaleve të ndryshme të informacioneve, duke i përfshirë edhe rrjetet e bashkëpunëtorëve në sektorin qytetar dhe atë mediatik, si dhe nga vetë institucionet nëpërmjet Ligjit për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik.

Për ndjekje më të mirë dhe të rregullt të gjendjeve me realizimin e reformave mediatike, në kuadër të projektit realizohen aktivitete të **vëzhgimit periodik dhe ditor** të ueb-faqeve relevante për përmbajtjet që kanë të bëjnë me reformat mediatike.

Aktivitetet e projektit përfshijnë edhe realizimin e mbledhjeve të dy **grupe të fokusit** që të fitohen informata nga personat dhe ekspertët që kanë informata kyçe nga fushat që kanë të bëjnë me realizimin e RUP-it nga sektori qytetar, akademik, privat dhe ai qytetar. Njohuritë nga grupi i parë i fokusit që u mbajt më 9 tetor të vitit 2017 janë përfshirë në rezultatet e vëzhgimit dhe do të shërbejnë si udhëzime për aktivitetet e më tutjeshme për vëzhgim dhe për hulumtime gazetareske.

Për prezantimin e konstatimeve të vëzhgimit, si dhe për të nxitur dialog më të gjerë ndërmjet krijuesve të politikave dhe faktorëve të tjerë ose publikut, parashihen **dy debate publike**, të cilat kanë për qëllim ta kycin shoqërinë qytetare në këto procese.

Rezultatet e vëzhgimit publikohen në formë të **analizave tremujore dhe të analizës përfundimtare**. Në nivel të projektit, këto informata do të plotësohen me **artikuj hulumtues**, nëpërmjet të të cilëve qytetarëve do t'u ofrohen njohuri plotësuese për kontekstin, gjendjet paraprake që kanë çuar në gjendjet aktuale, si dhe obligimet që janë ndërmarrë nga institucionet e RM-së për realizimin e reformave prioritare.

Vëzhgimi realizohet nga ana e një ekipi multi-diciplinar të projektit, të përbërë nga anëtarët e tre organizatave partnere me ekspertizë komplementare (gazetarë, ekspertë mediatikë dhe juristë).

Sipas metodologjisë, aktivitetet hulumtuese konstatojnë katër nivele të realizimit të obligimeve që dalin nga RUP në fushën "Mediat: liria e të shprehurit". Këto katër nivele janë:

1. Fare e porealizuar – asgjë konkrete nuk është filluar.
2. E filluar, mirëpo e porealizuar – kanë filluar aktivitetet për ndryshimin e legjislacionit.

3. Pjesërisht e realizuar – janë bërë ndryshimet ligjore, mirëpo nuk ka filluar implementimi.
4. Plotësisht e realizuar – reformat janë realizuar në tërësi.

Gjatë paraqitjes vizuale, për komunikim më të lehtë me publikun e gjerë, do të përdoren kode me ngjyrë për secilin nga këto nivele të përcaktuara të realizimit (e kuqe, portokalle, e verdhë dhe e gjelbër).

1. Fare e porealizuar – asgjë konkrete nuk është filluar.	
2. E filluar, mirëpo e porealizuar – kanë filluar aktivitetet për ndryshimin e legjislacionit.	
3. Pjesërisht e realizuar – janë bërë ndryshimet ligjore, mirëpo nuk ka filluar implementimi.	
4. Plotësisht e realizuar – reformat janë realizuar në tërësi.	

Fotografia 1: Nivelet e realizimit dhe kodet e ngjyrave.

Aktivitetet për vëzhgimin e gjendjeve i realizon ekipi multi-diciplinar i projektit, i përbërë nga anëtarët e tre organizatave partnere me ekspertizë komplementare (gazetarë, ekspertë mediatikë dhe juristë).

Hulumtimi

Reformat prioritare nga fusha “Mediat: liria e të shprehurit” parashohin ndërmarrje të një sërë masash dhe aktiviteteve konkrete që duhet t’i ndërmarrin institucionet relevante të vendit me qëllim të arritjes së përparimit drejt demokratizimit dhe qeverisjes së mirë. Këto masa dhe aktivitete janë ndarë në katër shtylla për realizimin e reformave të parapara në fushën e mediave: Transmetuesi publik i radiodifuzionit, reklamimi qeveritar, qasja te informatat dhe shpifja. Në kuadër të secilës nga shtyllat janë paraparë veprime plotësuese që kontribuojnë për realizimin e qëllimit të shtyllës kryesore. Sipas RUP, reformat që duhet të realizohen në këtë sferë janë:

Transmetuesi publik i radiodifuzionit: të sigurohen dëshmi të dukshme për reforma në transmetuesin publik të radiodifuzionit në aspekt të politikës së punës, organizimit, edukimit dhe redaksisë dhe mungesës së pavarësisë politike, mungesës së raportimit të balancuar, si dhe sigurimit të përmbajtjeve informative, me cilësi të lartë.

Reklamimi qeveritar: të vendosen rregulla të rrepta për reklamim qeveritar të bazuar në kriteret transparente, objektive dhe jodiskriminuese; të sigurohet transparencë e plotë e reklamimit qeveritar dhe të zhvillohet mekanizëm për publikime falas në transmetuesin publik, të cilat me të vërtetë janë me interes publik.

Qasja te informatat: të trajtohen pengesat kryesore me të cilat ballafaqohen gazetarët gjatë marrjes së informatave publike.

Shpifja: Zvogëlimi i rasteve të shpifjeve duke e ndryshuar legjislacionin, duke i ndryshuar rregullat procedurale, duke e mbështetur dhe duke e promovuar përdorimin më të madh të vetërregullimit si alternativë për procedurën gjyqësore, si dhe garantimi dhe zbatimi, në nivel politik, i praktikimit adekuat të vetëkufizimit nga politikanët dhe funksionarët publikë që të mos iniciohet procedurë për shpifje, në përputhje me parimet e GJEDNJ-së.

Raportet e Grupit të ekspertëve të pavarur me përvojë, të udhëhequr nga R. Pribe

Ndjekja e implementimit të reformave prioritare bëhet rregullisht nga ana e Komisionit Evropian, gjegjësisht nga grupi i ekspertëve të lartë të pavarur që e formoi KE-ja për ta analizuar situatën dhe për të ofruar rekomandime për çështjet sistematike sa i përket sundimit të të drejtës, e të cilat janë të lidhura me ndjekjen e komunikimeve, që u zbulua në pranverë të vitit 2015.

Raporti i parë i grupit të ekspertëve, i cili u publikua në qershor të vitit 2015, i konstatoi mangësitë dhe problemet kyçe në sferën mediatike në vend dhe dha rekomandime për zgjidhjen e tyre menjëherë pas realizimit të reformave në pushtet dhe në institucione. Problemet kyçe që u përmendën kanë të bëjnë me ndikimin politik dhe financiar mbi transmetuesin publik të radiodifuzionit dhe mbi mediat e tjera, reklamimin qeveritar, qasjen të informatat me karakter publik dhe shpifjen.

Në shtator të vitit 2017, Grupi i ekspertëve të pavarur me përvojë e përgatiti raportin e parë, me të cilin u bë vlerësim i përparimit në trajtimin e konstatimeve dhe të rekomandimeve të tyre paraprake, që u dhanë në raportin e parë në vitin 2015. Me këtë raport, në masë të madhe u konstatuan problemet dhe sfidat paraprake në sferën mediatike dhe lirinë e të shprehurit dhe është konstatuar shkallë e ulët ose e kufizuar e realizimit të reformave të parapara. Duke e pasur parasysh këtë, mbeten të vlejshme edhe më tutje rekomandimet e dhëna në raportin e parë në vitin 2015, e në mënyrë plotësuëse janë dhënë edhe rekomandime të reja. Rekomandimet e reja nga raporti i vitit 2017 kanë të bëjnë me ndërtimin e strategjisë qeveritare për realizimin e reformave në media, të bazuar në analizë adekuate dhe në planifikim në mënyrë transparente dhe pjesëmarrëse me përfaqësuesit e të gjithë faktorëve relevantë nga sektori publik dhe ai privat. Rekomandimet kanë të bëjnë edhe me përmirësimin e kapaciteteve të mediave dhe me përforcimin e rolit të tyre për shtet llogaridhënës, gazetari hulumtuese etj. Rekomandimet e tjera kanë të bëjnë me përmirësimin e funksionimit të “Radiotelevizionit të Maqedonisë” (RTM) në aspekt të pavarësisë së tij dhe udhëheqjes dhe punës efektive, si dhe transparencës dhe llogaridhënies ndaj të gjithë faktorëve. Poashtu, duhet të sqarohet situata me financimin e Agjencisë për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike që të sigurohet pavarësia e saj dhe pavarësia e Këshillit të saj.

Implementimi i RUP, poashtu, është vëzhguar edhe nga organizatat dhe institucionet e tjera ndërkombëtare, si dhe nga sektori qytetar dhe nga mediat në Maqedoni. Konstatimet dhe përfundimet e tyre, në përgjithësi, përputhen me gjendjet e konstatuara dhe problemet edhe sfidat e identifikuar në raportet e Pribes.

Nga ana tjetër, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe institucionet e tjera informojnë për aktivitetet e tyre për realizimin e reformave prioritare. Në periudhën e deritanishme nga analiza e informatave dhe e dokumenteve të tyre vërehet se një pjesë e reformave të parapara janë në realizim e sipër.

Gjatë përgatitjes së raportit nga vëzhgimi, përveç dy raporteve të Rajnhard Pribes, u shfrytëzuan edhe produktet gazetareske të agjencisë së lajmeve “[Meta](#)”, storjet e “[PINA](#)”, raportet nga vëzhgimi zgjedhor i [ASHAAM](#)-it dhe konstatimet e paraqitura në mbledhjen e grupit të fokusit të përbërë nga profesionistët mediatikë për nevojat e këtij projekti.

Konstatimet kyçe nga vëzhgimi

E filluar, mirëpo
e përealizuar

1. Transmetuesi publik i radiodifuzionit

Në kuadër të shtyllës së parë të RUP në fushën e mediave, janë dhënë rekomandime të qarta:

“ - të sigurohen dëshmi të dukshme për reformat aktuale në transmetuesin publik të radiodifuzionit në aspekt të politikës së punës, organizimit, edukimit dhe redaksisë, që kanë për qëllim marrjen me kritikën që janë theksuar rregullisht në të kaluarën në lidhje me mungesën e pavarësisë politike, mungesës së raportimit të balancuar, si dhe sigurimit të përmbajtjeve informative, me cilësi të lartë.”

1.1 Reformat në transmetuesin publik të radiodifuzionit akoma janë të padukshme si për ekspertët ashtu edhe për publikun e gjerë. Përveç heqjes së taksës për radiodifuzion¹⁹, e cila ishte e detyrueshme për qytetarët, nuk u bënë ndryshime të konsiderueshme në avancimin e funksioneve, obligimeve dhe rolit që do të duhej ta ketë transmetuesi publik i radiodifuzionit - RTM. [Monitoringu dhe analizat profesionale](#)²⁰ të bëra nga sektori civil treguan mungesë të transparencës në punën e organeve dhe trupave udhëheqës të RTM-së, për të cilin nuk ka informata si ka punuar, cilat dokumente dhe politike që i ka miratuar në kuadër të kompetencave të veta.

Ndonëse janë bërë ndryshime në mënyrën e financimit të RTM-së, ato nuk garantuan përmirësim të programit, e as konsolidim financiar. Disa nga shoqatat profesionale mendonin se buxheti që e planifikon qeveria nuk do të jetë i mjaftueshëm për funksionimin e saj papenguar, e këtë e treguan edhe analizat e buxhetit të RTM-së, si dhe analizat e punës financiare të RTM-së [Analiza buxhetore](#)²¹ për vitin 2017, e cila tregon se parashikimet e këtilla, RTM-ja do të ketë buxhet më të vogël, midis 5 dhe 7 milion euro. Nga ana tjetër, [RTM-ja njoftoi](#)²² se problemi me borxhet do të zgjidhej sikur DHP-ja të mos kërkonte nga RTM-ja që të paguajë një shumë prej 34 milionë eurosh.

Për politizimin dhe anshmërinë partiake që ende është e pranishme në transmetuesin publik qartë bënë me dije raportet e ASHAAM-it nga ndjekja²³ e raportimit mediatik gjatë zgjedhjeve lokale në vitin 2017. ASHAAM-i në dy raporte në gjetjet nga monitorimi konstatoi mosbalancim të transmetuesit publik i radiodifuzionit. 4. Në [raportin e saj të 4 dhjetëditor](#)²⁴

¹⁹ Propozim-ligji për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike, me procedurë të shkurtuar

<http://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialId=d9c2f24d-4522-4e39-aab6-0c9bf85ebbd9>

²⁰ <http://meta.mk/aavmu-mora-da-bide-vistinski-nositel-na-politiki-za-mediumite-ne-samo-regulator/>

²¹ T. Blazhevski. (20.09.2017.) Kundërsin: RTM-ja do të ketë buxhet më të vogël për 5 deri në 7 milionë euro!

Vërtetmatësi. <http://vertetmates.mk/kunderspin-rtm-do-te-kete-buxhet-me-te-vogel-per-2-milion-euro/>

²² Meta.mk. (03.11.2017.) RTM-ja: Ne kemi shumë borxhe, por edhe DHP-ja na ka borxh neve prej 34 milionë eurosh.

<http://meta.mk/mrt-nie-dolzime-mnogu-ama-i-ujp-ni-dolzhi-34-milioni-evra/>

²³ ASHAAM. Raporte dhjetëditore nga monitoringu i raportimit mediatik për zgjedhjet lokale të vitit 2017.

<http://avmu.mk/%d0%b4%d0%b5%d1%81%d0%b5%d1%82%d0%b4%d0%bd%d0%b5%d0%b2%d0%bd%d0%b8-%d0%b8%d0%b7%d0%b2%d0%b5%d1%88%d1%82%d0%b0%d0%b8-%d0%be%d0%b4-%d0%bc%d0%be%d0%bd%d0%b8%d1%82%d0%be%d1%80%d0%b8%d0%bd%d0%b3%d0%be/>

²⁴ ASHAAM. Zgjedhjet lokale 2017: Raport nga monitoringu për raportimin mediatik për periudhën prej 6 deri më 15 shtator 2017. <http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/09/lzvestaj-za-period-od-6-do-15-septemvri-2017.pdf>

për programit e parë të RTM-së, ASHAAM-i konstatoi se: "...në momente ka bërë zgjedhje jokritike gjatë transmetimit të pikëpamjeve të partisë më të madhe opozitare (për shembull, katër herë në temën e njëjtë transmetoi reagime të VMRO-DPMNE-së ndaj Rashkovskit - sekretarit të përgjithshëm të qeverisë). Kështu, TVM1 nuk iu përmbajt përcaktimit nga rregullat e saj për mbulimin mediatik të zgjedhjeve lokale, sipas të cilit në lajmet deri në fillimin e fushatës zgjedhore do të sigurojë raportim të balancuar për aktivitetet e partive politike nga partitë në pushtet dhe ato opozitare që janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ... "5. [Në raportin e saj të 5 dhjetëdito](#)²⁵, ASHAAM-i konstatoi shkelje të dispozitave të Kodit zgjedhor, gjegjësisht transmetim të deklaratave të një bartësi të funksionit publik gjatë heshtjes zgjedhore për rrethin e dytë zgjedhor të zgjedhjeve lokale.

Kanali i katërt televiziv i RTM-së, për të cilin u sollën ndryshime ligjore para dy vitesh, akoma nuk ka filluar me punë. Ky kanal duhet të emetojë program vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa programet në gjuhët e bashkësive të tjera etnike do të transmetohen në kanalin ekzistues. Për këtë konfigurim të ri të programit, si dhe për gjendjen me personelin e transmetuesit publik, u diskutua edhe [brenda RTM-së](#)²⁶ dhe në [debatin](#)²⁷ kushtuar gjendjeve në RTM, që u organizua nga OSBE-ja në nëntor të vitit të kaluar.

Reagimi plotësues negativ shkaktoi vendimi i Këshillit programor të RTM-së, [që ta rizgjedhë](#)²⁸ drejtorin aktual, nga 13 kandidatë të paraqitur në konkursin e publikuar në janar të vitit 2018. Këto [reagime në mesin e ekspertëve](#)²⁹ u paraqitën për shkak të kontraversave që e shoqëruan mandatin e tij paraprak.

Në korrik të vitit 2018 mjetet e zvogëluara financiare të RTM-së u plotësuan kur me [rebalancin e buxhetit në Kuvend](#) për të u ndanë edhe 3 milionë euro të tjera mjete buxhetore.³⁰

[Raporti vjetor](#)³¹ për punën e RTM-së për vitin 2017, i cili ishte dorëzuar në Kuvendin e RM-së më 30.03.2018, si dhe u shqyrtua dhe u miratua në [mbledhjen plenare të Kuvendit](#) në gusht të vitit 2018³². Dinamika e njëjtë e Kuvendit u përsëri edhe me [raportin vjetor](#)³³ për vitin 2017, të dorëzuar nga Agjencia për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike. Ai ku konstatua në [mbledhjen](#) e Komisionit për transport, lidhje dhe ekologji³⁴, nga e cila u dorëzua raport në Kuvend për procedurë të mëtutjeshme. Më 23.7.2018 në mbledhje plenare të Kuvendit u konstatua raporti vjetor për punën e ASHAAM-it për vitin e kaluar 2017.

- 1.2. Ngecja e reformave në transmetuesin publik të radiodifuzionit u zhvillua në korrelacion të ngjashëm me ngecjet në ndryshimet dhe avancimet e rregullativës mediatike.

²⁵ ASHAAM. Zgjedhjet lokale 2017: Raport nga monitoringu për raportimin mediatik për periudhën prej 16 deri më 24 shtator 2017. <http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/09/Izvestaj-od-monitoring-za-lokalni-izbori-2017-za-period-od-16-do-24-septemvri.pdf>

²⁶ M. Atanasoska-Manasieva (30.11.2017) TVM-ja merr frymë në aparate të vjetra, ka video-sinjal të dobët, ndërsa për audio të dytë as që e ka idenë, Observatori për reforma mediatike. <http://mediaobservatorium.mk/sq/tvm-ja-merr-fryme-ne-aparate-te-vjetra-ka-video-sinjal-te-dobet-ndersa-per-audio-te-dyte-as-qe-e-ka-idene/>

²⁷ Observatori për reforma mediatike (27.11.2017), Programet e RTM-së në gjuhët e nacionaliteteve mezi se ia dalin në fund, <http://mediaobservatorium.mk/programite-na-mrt-na-jazitsite-na-natsionalnostite-edvaj-sostavuvaat-kraj-so-kraj/>

²⁸ <http://mediaobservatorium.mk/marjan-tsvetkovski-reizbran-za-direktor-na-mrti-ten-od-13-prijaveni-kandidati/>

²⁹ <http://mediaobservatorium.mk/znm-reizborot-na-tsvetkovski-za-direktor-ne-odi-vo-prilog-na-reformite-na-mrt/>

³⁰ <http://meta.mk/staro-noviot-menadhment-na-mrt-dobi-infuzija-od-3-milioni-evra-infografik/>

³¹ <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialId=a5cac699-06a1-46bb-ac76-5b135b3766e8>

³² <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialId=72ca896a-dfae-4d03-80e1-68a7e3c56b16>

³³ <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialId=967e5063-679b-4d12-8c2d-efa93f419d98>

³⁴ <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialId=967e5063-679b-4d12-8c2d-efa93f419d98>

Pas një sërë [debatesh dhe konsultimesh](#)³⁵, në fund të shkurtit të vitit 2018, [qeveria e miratoi](#)³⁶ Propozim-ligjin për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike, i cili pastaj iu dërgua Kuvendit për shqyrtim dhe votim. Gjatë muajit mars të vitit 2018, [Propozim-ligji](#)³⁷ u [debatua](#)³⁸ në disa Komisione kuvendore në Kuvend. Dinamika me të cilën u shqyrtua Ligji për ASHAAM-in në organet kuvendore bëri me dije se ai nuk do të miratohet për kohë të shkurtër. Për indikacionet e këtilla [me qëndrimin e tij u paraqit](#) edhe njeriu i parë i ministrisë përkatëse, Damjan Mançevski, duke e akuzuar opozitën se po i pengon proceset³⁹. Nga ana tjetër, partia opozitare VMRO-DPMNE kërkoi [përrjashtim të publikut](#)⁴⁰ në debatin për kandidatët për anëtarë të Komisionit në kuadër të ASHAAM-it dhe për anëtarë të Këshillit programor të RTM-së. Përveç kësaj, partia opozitare e kundërshton dispozitën e propozuar ligjore që anëtarët e organeve udhëheqëse [detyrimisht të rekomandohen nga sektori civil](#)⁴¹.

Aksionet reformuese u ngadalësuan, ndryshimet ligjore akoma nuk e kanë kaluar procedurën kuvendore edhe përkundër [reagimeve](#)⁴² dhe [paraqitjet publike](#)⁴³ të sektorit civil, të komunitetit profesional të OJQ-ve, me qëllim të përshpejtitimit të proceseve në Kuvend gjatë miratimit të ndryshimeve ligjore e pastaj edhe zbatimit të tyre.

³⁵ <http://mediaobservatorium.mk/predlog-zakonot-za-avmu-povtorno-na-meta-na-ekspertite-i-felata/>

³⁶ <http://mediaobservatorium.mk/vladata-go-usvoi-predlog-zakonot-za-audio-i-audiovizuelni-mediumski-uslugi/>

³⁷ <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialId=e71f01ff-4bd8-428a-b45e-ccf4687b774a> (linku i fundit i memoruar më 31.03.2018 në orën 16:50)

³⁸ <http://mediaobservatorium.mk/so-serija-zabeleshki-zakonot-za-avmu-slednata-nedela-odi-na-plenarka-vo-sobraniето/>

³⁹ <http://mediaobservatorium.mk/manchevski-opozitsijata-chetiri-mesetsi-gi-kochi-mediumskite-zakoni/>

⁴⁰ <http://mediaobservatorium.mk/vmro-dpmne-ne-saka-javna-rasprava-za-kandidatite-za-aavmu-i-sovetot-na-mrt/>

⁴¹ <http://mediaobservatorium.mk/vmro-dpmne-bara-nevladinite-da-ne-izdavaat-preporaki-za-chlenovite-na-sovetite-na-aavmu-i-mrt/>

⁴² <http://mediaobservatorium.mk/znm-bara-da-se-prekine-mandatot-na-chlenovi-na-sovetite-na-mrt-i-na-aavmu/>

⁴³ <http://mediaobservatorium.mk/reformite-vo-mediumskata-sfera-mora-da-prodolzhata-POSEOPFATNO/>

Pjesërisht e
realizuar

2. Reklamimi qeveritar

Sipas RUP, në fushën e “reklamimit qeveritar”, RM-ja duhet t’i përmbushë këto gjëra:

- të vendosen rregulla të rrepta për reklamimin qeveritar, të bazuara në kritere transparente, objektive dhe jodiskriminuese;
- të sigurohet transparencë e plotë e reklamimit qeveritar (jo vetëm në aspekt të shpenzimit të parave publike, por edhe në aspekt të pranuesve të tyre dhe përmbajtjeve);
- të zhvillohet një mekanizëm për shpalljet falas në transmetuesin publik të cilat me të vërtetë janë me interes publik”.

Pas masës së miratuar nga qeveria⁴⁴ më 22.8.2017, me të cilën u hoqën reklamat qeveritare, akoma nuk është miratuar dhe nuk është publikuar asnjë dokument me të cilin saktësisht përcaktohen rregulla për reklamimin e mundshëm qeveritar përmes rrjeteve sociale të cilat janë përmendur si përjashtim. Përveç kësaj, nuk dihet nëse përgatitet ose tashmë është përgatitur ndonjë dokument me të cilin përcaktohen kriteret për definimin e termit interes publik dhe temave përkatëse me interes publik, për të cilat do të komunikojë me qytetarët nëpërmjet publikimeve pa pagesë në transmetuesin publik të radiodifuzionit.

Nga qeveria akoma nuk janë dhënë sqarime të detajuara për disa specifika në aspekt të kësaj problematike dhe mbetën të paprecizuara disa çështje, të cilat imponohen:

- 1.1. A do të paguajë qeveria reklama kur do të komunikojë me publikun nëpërmjet transmetuesi publik të radiodifuzionit RTM?
- 1.2. A planifikon qeveria, kur informon se do të komunikojë me publikun nëpërmjet rrjeteve sociale, të paguajë për produksionin e klipeve ose publikimeve reklamuese, të cilat pastaj do të emetohen si reklama të paguara në Facebook, Twitter dhe në rrjetet e tjera sociale?
- 1.3. Në çfarë mënyre qeveria do ta përdorë departamentin e saj për marrëdhënie me publikun dhe të punësuarit e tij në funksion të rolit të saj proaktiv gjatë komunikimit me publikun nëpërmjet Facebook-ut, Twitter-it dhe rrjeteve të tjera sociale?

Mundësia për reklamim e qeverisë, institucioneve qeveritare dhe e ndërmarrjeve të tjera publike është lënë në Propozim-ligjin e ri për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike, në nenin 102 të Propozim-ligjit⁴⁵, ku thuhet se institucionet e lartpërmendura në qoftë se kanë mjete të parapara për komunikim me publikun “...janë të obliguara t’i realizojnë ato në mënyrë jodiskriminuese, objektive dhe transparente në procedurë të përcaktuar me Ligjin për furnizime publike...”.

Edhe pse më i shpeshtë është komunikimi i institucioneve qeveritare dhe i individëve me publikun nëpërmjet rrjeteve sociale Facebook dhe Twitter, nga qeveria njoftuan se do të hapin kanal të ri plotësues⁴⁶ për informim dhe për komunikim me publikun.

Zëdhënësi i qeverisë, megjithatë, sqaroi⁴⁷ se për onlajn reklamim në Facebook dhe në Twitter janë harxhuar rreth 250 euro.

⁴⁴ <http://vlada.mk/node/13272> (linku i memoruar për herë të fundit më 30.9.2018, në orën 16:50)

⁴⁵ <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialId=e71f01ff-4bd8-428a-b45e-ccf4687b774a>

⁴⁶ <http://meta.mk/vladata-otvora-kanal-za-onlajn-komunikatsija-so-graganite-nema-da-dava-pari-za-reklami/>

⁴⁷ <http://mediaobservatorium.mk/vladata-platila-samo-250-evra-za-reklami-na-fejsbuk-i-tviter/>

Në periudhën e ndjekjes dhe të raportimit (1.7.2017 – 30.9.2018) nuk janë vërejtur klipe, reklama dhe komunikim tjetër me pagesë me publikun nëpërmjet transmetuesit publik, e në funksion të promovimit të aktiviteteve qeveritare.

Pjesërisht e
realizuar

3. Qasja në informata

Për fushën e qasjes në informatat me karakter publik, në kuadër të RUP kërkohet:

- “të trajtohen pengesat kryesore me të cilat përballen gazetarët gjatë marrjes së informatave publike (p.sh. mosarritja e organeve relevante që të përgjigjen në shumë kërkesa për informata, përdorimi i tepërt pa arsye i termit “sekret” për dokumentet të nuk kanë natyrë të tillë)”.

Pas vendimeve të miratuara nga qeveria dhe një sërë masash për përmirësimin e qasjeve në informatat me karakter publik: qasja e hapur në internet në [seancat e qeverisë](#)⁴⁸; qasje falas për gazetarët në Regjistrin Qendror dhe në Kadastrin e RM-së, megjithatë mbetën disa gjëra të paqartësuara, të cilat publiku i gjerë i ekspertëve priste përmirësime dhe saktësime në muajt e monitorimit (1.7.2017-30.9.2018).

Mbeten paqartësitë në lidhje me gazetarët e lirë, të cilët nuk kanë redaksi dhe nuk dihet nëse kjo qasje e lirë i përjashton ata, komunitetin akademik, OJQ-të dhe institucionet e tjera hulumtuese. Përveç kësaj, nuk dihet nëse deri tani është emëruar ndonjë person i autorizuar ose ndonjë funksion me kompetencë të refuzojë kërkesë për qasje të lirë në informatat nga të dyja institucionet dhe në cilat kushte një kërkesë e tillë mund të refuzohet nga institucioni që posedon informata me karakter publik.

Për qasjen në informatat me karakter publik u mbajt një [debat publik](#)⁴⁹ mbi nevojën për ndryshimin e Ligjit për qasje në informatat me karakter publik, i organizuar nga Ministria e Drejtësisë, ku u paraqitën vërejtje dhe të dhëna që e mbështesin nevojën për ta ndryshuar ligjin ekzistues. Për këtë qëllim qeveria paralajmëroi ndryshime dhe plotësime të Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik, që gjatë periudhës së kaluar disa herë është kërkuar nga organizatat të ndryshme qytetare dhe punonjës të medias. Për këtë qëllim, MSHIA-ja me Ministrinë e Drejtësisë dhe ministrit pa resor të angazhuar për komunikim, llogaridhënie dhe transparencë, në një [njoftim me shkrim për publikun](#)⁵⁰ u bëri thirrje qytetarëve, mediave dhe organizatave qytetare të japin propozime dhe sugjerime për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për qasje në informatat me karakter publik .

Edhe përkundër paralajmërimeve për ndryshime të ligjit, aktivitetet mbetën në fazë të hershme të përgatitjeve. Siç [njoftoi Ministria për Drejtësi gjatë muajit shkurt](#), grupet e punës që duhet t'i përgatisin ndryshimet në ligjin ekzistues ende ishin në fazën e formimit.

⁴⁸ Qeveria e RM-së, <http://vlada.mk/sednici>

⁴⁹ Observatori për reforma mediatike, (19.12.2017) <http://mediaobservatorium.mk/administratsijata-najmalku-odgovara-na-novinarskite-prashana/>

⁵⁰ Observatori për reforma mediatike (20.12.2017) <http://mediaobservatorium.mk/povik-za-predlozi-i-sugestii-za-noviot-zakon-za-sloboden-pristap-do-informatsii/>

Gjatë periudhës së monitorimit, organizatat e shoqërisë civile në disa raste e potencuan domosdoshmërinë e ndryshimeve dhe plotësimeve në Ligjin aktual për qasje në informata me karakter publik. Kërkesat e këtilla u [shprehën publikisht](#)⁵¹ nëpërmjet mjeteve të informimit publik.

Sfidat kryesore të cilat i potencuan organizatat qytetare dhe ekspertët nga kjo fushë janë përmbledhur në dokumentin për politika publike "[Propozime për ndryshimin e Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publike dhe përmirësimi i zbatimit të tij](#)"⁵² të publikuar nga FSMM-ja akoma mbeten duke pasur parasysh faktin se nuk ka filluar puna për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik.

Deri në mbylljen e këtij raporti (30.9.2018) nuk ka informata nga Ministria për Drejtësi, se deri ku ka arritur procesi i përgatitjes së ndryshimeve dhe i plotësimeve të Ligjit ekzistues.

Edhe përkundër sfidave me të cilat përballen qytetarët gjatë qasjes në informatat me karakter publik, rrethanë tjetër vështirëuese është jofunksionaliteti aktual i [Komisionit për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik](#). Në fakt, pas [dorëheqjes](#) së kryetarit të Komisionit, Sllamkov⁵³, dhe mungesës së dy anëtarëve të Komisionit, ky organ nuk mund të sjellë vendime për ankesat e qytetarëve për qasjen në informatat me karakter publik. Edhe pse në Kuvend u anulua konkursi i parë⁵⁴ për zgjedhjen e kryetarit dhe të dy anëtarëve, më [29.9.2018 përsëri u soll vendim](#) për shpallje publike për zgjedhjen e kryetarit dhe dy anëtarëve⁵⁵. Edhe përkundër mbledhjeve të paralajmëruara në të cilat është dashur të zgjidhen, deri në mbylljen e këtij raporti (30.9.2018) akoma nuk ka informata për zgjedhjen dhe kompletimin e Komisionit. Nga Sekretariati i Komisionit informuan se ankesat e pranuar janë procesuar dhe janë përpunuar dhe pritet kompletimi i Komisionit i cili ka mandat për t'i sjellë vendimet në lidhje me ankesat.

Edhe përkundër ndryshimeve të pamiratuara ligjore, disa institucione shtetërore e avancuan transparencën dhe llogaridhënien e tyre ndaj qytetarëve, nëpërmjet të dhënave onlajn, të cilat i vënë në dispozicion për publikun.

Në fillim të janarit, Ministria e Financave njoftoi se në [Sistemin elektronik për furnizime publike](#)⁵⁶, do të publikohen edhe kontratat e ndara me ç'rast publiku do të ketë qasje në to. Kontratat duhet të jenë të disponueshme brenda vetë njoftimeve për furnizimin e nënshkruar. Qeveria njoftoi se kjo masë është miratuar me qëllim që të parandalohen përpjekjet për korrupsion gjatë lidhjes së marrëveshjeve ndërmjet organeve shtetërore dhe kompanive.

Përveç kësaj, Ministria e Financave paralajmëroi se në bashkëpunim me Institutin ndërkombëtar republikan (IRI) po përgatisin një [portal të quajtur "Financa të hapur" për të cilin paralajmërojnë se do të fillojë të përdoret nga fundi i vitit 2018](#)⁵⁷. Qëllimi i këtij portali është që t'i përfshijë të gjitha të dhënat për shpenzimin e parave të qytetarëve, për çka janë shpenzuar ato, si dhe cili institucionin kujt i ka paguar para dhe për cilin qëllim. Nga Ministria për Financa njoftuan se për këtë projekt do të përdoren përvojat nga Sllovenia dhe Shqipëria, ndërsa të dhënat në dispozicion do të përditësoheshin çdo dy javë.

⁵¹ <https://www.24.mk/vladata-i-zasegnatite-strani-go-podgotvuvaat-noviot-zakon-za-sloboden-pristap-do-informacii>

⁵² "Propozime për ndryshimin e Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publike dhe përmirësimi i zbatimit të tij" (12.01.2018) <http://fosm.mk/CMS/Files/Documents/Policy%20Brief%2012-01-2018.pdf>

⁵³ <https://novatv.mk/ostavka-na-sllamkov-od-komisijata-za-sloboden-pristap-do-informatsii/>

⁵⁴ Më 27.8.2018 është anuluar konkursi i parë për zgjedhjen e kryetarit të Komisionit dhe dy anëtarëve të tij

⁵⁵ <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialId=ba4ad232-ca03-4d45-9995-c87b48cd3ae2>

⁵⁶ <https://e-nabavki.gov.mk/PublicAccess/Home.aspx#/home>

⁵⁷ <http://meta.mk/na-portalot-otvoreni-finansii-ke-se-sledi-trosheneto-na-parite-na-graganite/>

Ministria për Mbrojtje informoi⁵⁸ se i ka hapur për publikun të gjitha furnizimet dhe shpenzimet që nuk janë me karakter të klasifikuar. Rrogat e të punësuarve në Ministri, shërbimet dhe furnizimet publike janë në dispozicion në një [faqe të veçantë](#) në ueb-faqen e këtij institucioni.

Aktiviteti i vetëm në këtë drejtim ishte bashkëpunimi i paralajmëruar më i afër i definuar me memorandumin e nënshkruar ndërmjet [Shoqatës së gazetarëve të Maqedonisë dhe Komisionit për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik](#)⁵⁹. Me këtë pritet që komunikimi ndërmjet gazetarëve nga njëra anë dhe institucioneve nga ana tjetër të jetë më efikas dhe më i shpejtë kur bëhet fjalë për marrjen e informatave që janë të nevojshme me shpejtësi për kryerjen e detyrave gazetareske.

⁵⁸ <http://mediaobservatorium.mk/ministerstvoto-za-odbrana-se-otvora-kon-javnosta-i-ke-objavuva-se-shto-ne-e-tajno/>

⁵⁹ <http://mediaobservatorium.mk/znm-dogovori-sorabotka-za-polesen-pristap-na-novinarite-do-informatsii-od-javen-karakter/>

Fare e
perealizuar

4. Shpifja

Reformat prioritare për mediat në fushën e katërt – shpifja – parashohin:

“...zvogëlim të numrit të rasteve të shpifjes që arrijnë në gjykata, gjë që duhet të arrihet me: ndryshim të legjislacionit që të largohen rastet e llojit “nderi”, “dinjiteti” dhe “ofendimi”, të cilat iniciohen në përputhje definicionin ligjor të ofendimit, mirëpo të cilat janë jashtë diapazonit të ofendimit në kuptim të nenit 10 të KEDNJ-së; ndryshim të rregullave procedurale për përjashtimin e rasteve të vogla, dhe në vend të kësaj të ketë rritje të zbatimit të ndërmjetësimit gjatë zgjidhjes së tyre; ndryshim dhe promovim të përdorimit më të madh të vetërregullimit si alternativë për shqyrtimin gjyqësor; garantim dhe zbatim, në nivel politik të praktikimit të vetëkufizimit adekuat nga politikanët dhe funksionarët publikë që të mos iniciohet procedurë për shpifje, në përputhje me parimet e GJEDNJ-së”.

Sipas raportit të fundit të Pribes të vitit 2017⁶⁰, i cili ndërlidhet me raportin e vitit 2015⁶¹, është regjistruar zvogëlim i rasteve gjyqësore për shpifje dhe për këtë pjesë të pakos reformuese thuhet se nuk trajtohet si fushë që brengos më së shumti.

Në periudhën e ndjekjes dhe raportimit për RUP (1.7.2017-30.09.2018) nuk ka asnjë ndryshim që nga publikimi i [Raportit të parë periodik](#)⁶², [Raportit të dytë periodik](#)⁶³ dhe të [Raportit të tretë periodik](#)⁶⁴ të Observatorit për reforma mediatike që do të tregonte se ka avancim të gjendjeve në fushën e padive për shkak të shpifjes dhe ofendimit, me të cilat u përballën gazetarët dhe punëtorët mediatikë. Nuk ka as paralajmërim për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe ofendim. Sipas [storjes hulumtuese](#)⁶⁵ të PINA – Platformës për gazetari hulumtuese dhe analiza, në Gjykatën Themelore Shkup 2, dukshëm janë zvogëluar kontestet për shpifje dhe ofendim në 24 muajt e fundit në krahasim me periudhën para vitit 2016.

Megjithatë, gjykatat kanë praktikë të ndryshme në interpretimin se një medie onlajn a është medie dhe a është i punësuar në të gazetar apo qytetar i zakonshëm. Si rezultat i interpretimeve të këtilla, ndryshe gjykohet edhe për paditë për shpifje dhe ofendim. Për praktikën e këtillë gjyqësore, (Gjykata civile në Shkup dhe Gjykata e Apelit, mirëpo jo edhe gjykatat e tjera në brendësi të vendit) [reagoi Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë](#) duke kërkuar nga Gjykata Supreme të veprojë në lidhje me kërkesën e tyre për harmonizimin e praktikës gjyqësore. Nga SHGM-ja informuan se kanë dërguar parashtresë në Këshillin gjyqësor për të gjithë gjykatësit që në mënyrë joadekuate dhe selektive e zbatojnë Ligjin për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe ofendim⁶⁶.

⁶⁰ Senior expert group. (14.09.2017.) The former Yugoslav Republic of Macedonia: Assessment and recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues 2017. https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf fq.24, paragrafi 122

⁶¹ Komisioni Evropian, DGJ Politika evropiane për fqinjësi dhe negociatat për zgjerim. Reformat urgjente prioritare për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (qershor 2015) https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_mk.pdf

⁶²

⁶³ http://mediaobservatorium.mk/wp-content/uploads/2018/02/OMR_izveshtaj_2.pdf

⁶⁴ http://mediaobservatorium.mk/wp-content/uploads/2018/05/OMR_izveshtaj_3_final.pdf

⁶⁵ <http://mediaobservatorium.mk/sudii-ne-gi-priznavaat-portalite-za-mediumi-vo-sluchajte-za-kleveta-i-navreda/>

⁶⁶ <http://mediaobservatorium.mk/znm-neodgovornoto-odnesuvane-na-nekoi-sudii-e-zaobikolen-obid-za-litsentsirane-na-mediumi-i-novinari/>

Literatura e shfrytëzuar

- Przino Agreement – Agreement in Skopje to overcome political crisis, 2 June 2015, Skopje.
- Prioritetet për reformat urgjente për Republikën e Maqedonisë, Komisioni Evropian, DGJ Politika evropiane për fqinjësi dhe negociatat për zgjerim, qershor 2015.
- Programi për punë i Qeverisë së RM-së, 2017- 2020.
- Plani “3-6-9” i Qeverisë së RM-së, 2017-2018.
- Recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues relating to the communications interception revealed in spring 2015.
- Assessment and recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues, 2017.
- Fondacioni Shoqëri e hapur - Maqedoni. “Propozime për ndryshimin e Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik dhe përmirësimi i zbatimit të tij” (12.01.2018)